



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2020 – Numri: 164

Tiranë – E hënë, 14 shtator 2020

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 695, datë 9.9.2020	Për një ndryshim në vendimin nr. 513, datë 13.7.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për pjesëmarrjen e një toge këmbësorie të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, me mision në Komandën e Trajnim-Këshillimit dhe Ndhmës në Herat, në kuadër të operacionit të NATO-s “RSM”, Afganistan”.....
	11949
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 697, datë 9.9.2020	Për emërimin në detyrë të Prefektit të Qarkut Shkodër.....
	11949
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 699, datë 10.9.2020	Për një ndryshim në vendimin nr. 608, datë 29.7.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për procedurat, kriteret dhe rregullat për zbatimin e programit të nxitjes së punësimit nëpërmjet punësimit të personave të dalë të papunë, si pasojë e COVID-19”.....
	11949
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 700, datë 9.9.2020	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 47, datë 22.1.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme, për vitin 2020, në njësitë e qeverisjes qendrore”, të ndryshuar.....
	11950
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 701, datë 9.9.2020	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 391, datë 1.6.2011, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e statutit të shoqërisë ‘Nxitja e biznesit social’ sh.a.”
	11951
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 705, datë 9.9.2020	Për kriteret e caktimit të shpërblimit të administratorit të përkohshëm të falimentimit, rregullat për shpërblimin e administratorit të falimentimit, si dhe kriteret dhe përlogaritja e shpërblimit të kujdestarit.....
	11952
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 707, datë 9.9.2020	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 182, datë 26.2.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e masës, të kriterëve, procedurave e dokumentacionit për vlerësimin dhe përfitimin e pagesës për personat me aftësi të kufizuara, si dhe të ndihmës personal”
	11954
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 708, datë 9.9.2020	Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit.....
	11957

Vendim i Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura nr. 77, datë 30.6.2020	Për një ndryshim në vendimin e Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 44, datë 14.10.2016, “Për licencimin e sha Ujësjetllës-Kanalizime Vorë”	11962
Vendim i Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura nr. 78, datë 30.6.2020	Për një ndryshim në vendimin e Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 22, datë 7.6.2017 “Për licencimin e sh.a. Ujësjetllës-Kanalizime Mat”	11963
Vendim i Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura nr. 91, datë 28.7.2020	Për licencimin e shoqërisë Ujësjetllës-Kanalizime Bulqizë sh.a.	11964
Vendim i Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura nr. 92, datë 28.7.2020	Për një ndryshim në vendimin e Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 12, datë 16.2.2018, “Për licencimin e sh.a. Ujësjetllës-Kanalizime Tepelenë, për ndryshim drejtuesi teknik”	11965
Vendim i Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura nr. 99, datë 25.8.2020	Për miratimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimin e ujërave të ndotura për shoqërinë Ujësjetllës-Kanalizime Pogradec sh.a.	11966
Vendim i Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura nr. 100, datë 25.8.2020	Për një ndryshim në vendimin nr. 39, datë 1.6.2018, “Për licencimin e sh.a. Ujësjetllës-Kanalizime Konispol”	11971

**VENDIM**

Nr. 695, datë 9.9.2020

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN
NR. 513, DATË 13.7.2016, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR
PJESËMARRJEN E NJË TOGE
KËMBËSORIE TË FORCAVE TË
ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË, ME MISION NË
KOMANDËN E TRAJNIM-
KËSHILLIMIT DHE NDIHMËS NË
HERAT, NË KUADËR TË
OPERACIONIT TË NATO-s
“RSM”, AFGANISTAN”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 7, të ligjit nr. 9363, datë 24.3.2005, “Për dërgimin e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë jashtë vendit, si dhe për mënyrën e procedurat e vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Fjala e parë, e pikës 4, të vendimit nr. 513, datë 13.7.2016, të Këshillit të Ministrave, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Kohëzgjatja e këtij misioni është deri në 10 dhjetor 2021.”.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i Ministrisë së Mbrojtjes.

3. Ngarkohet ministri i Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe**

VENDIM

Nr. 697, datë 9.9.2020

**PËR EMËRIMIN NË DETYRË TË
PREFEKTIT TË QARKUT SHKODËR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 5, të ligjit nr. 107/2016, “Për prefektin e qarkut”, me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Znj. Majlinda Angoni emërohet Prefekt i Qarkut Shkodër.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe**

VENDIM

Nr. 699, datë 10.9.2020

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN
NR. 608, DATË 29.7.2020, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR PROCEDURAT,
KRITERET DHE RREGULLAT PËR
ZBATIMIN E PROGRAMIT TË NXITJES
SË PUNËSIMIT NËPËRMJET
PUNËSIMIT TË PERSONAVE TË DALË
TË PAPUNË, SI PASOJË E COVID-19”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4, të nenit 11, të ligjit nr. 15/2019, “Për nxitjen e punësimit”, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pika 1, e kreut II, të vendimit nr. 608, datë 29.7.2020, të Këshillit të Ministrave, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“1. Punëkërkuessit me të drejtë përfitimi për programet, sipas shkronjave “a” dhe “b”, të pikës 2, të kreut III, janë të gjithë punëkërkuessit e papunë që kanë dalë të papunë si pasojë e COVID-19, të evidentuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe të regjistruar në zyrën e punësimit. Ndërsa, punëkërkuessit me të drejtë përfitimi për



programin, sipas shkronjës “c”, të pikës 2, të kreut III, janë ata të cilët deklarojnë që kanë qenë të punësuar, por nuk evidentohen si të tillë në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve dhe regjistrohen në zyrën e punësimit.”

2. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

VENDIM
Nr. 700, datë 9.9.2020

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA
NË VENDIMIN NR. 47, DATË 22.1.2020,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR
PËRCAKTIMIN E NUMRIT TË
PUNONJËSVE ME KONTRATË TË
PËRKOZHSHME, PËR VITIN 2020, NË
NJËSITË E QEVERISJES QENDRORE”,
TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 18, të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 12, të ligjit nr. 88/2019, “Për buxhetin e vitit 2020”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 47, datë 22.1.2020, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen ndryshimet dhe shtesat e mëposhtme:

a) Në pikën 1, numri i punonjësve me kontratë të përkohshme ndryshohet dhe bëhet 2 628 (dy mijë e gjashtëqind e njëzet e tetë) veta.

b) Në pikën 3, pas fjalëve “... dhe 5 mjekë, 5 specialistë dhe 5 punonjës socialë të Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror Tiranë, pranë Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, periudha kohore e të cilëve bëhet deri në fund të vitit ...” shtohen “... 35 punonjës të Qendrës Kombëtare të Urgjencës Mjekësore, pranë Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, periudha kohore e të cilëve bëhet deri në fund të vitit.”.

c) Në lidhjen nr. 1, të përmendur në pikën 1, në ndarjen “Gr. 13, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale”, në ndarjen “Gr. 14, Ministria e Drejtësisë” dhe në ndarjen “Gr. 87, Institucione të tjera qeveritare” shtohet nëndarja sipas tabelës nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Drejtësisë dhe Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit që të bëjnë detajimin e numrit të punonjësve me kontratë, periudhës kohore të punësimit dhe kategorisë përkatëse të pagës së tyre dhe ta depozitojnë pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe



Tabela nr. 1

Gr.	Emri i institucionit	Nr. i punonjësve	Emërtesa	Koha mesatare ditore	Periudhë kohore
13	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale	10			
	Qendra Kombëtare e Urgjencës Mjekësore	10	Shoferë ambulance	8 orë/ditë	31.12.2020
14	Ministria e Drejtësisë	1			
	Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas	1	Sanitar	8 orë/ditë	31.12.2020
87	Institucione të tjera qeveritare	20			
	Ajencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit	20	Specialist	8 orë/ditë	31.12.2020
	TOTAL PUNONJËS ME KONTRATË	31			

VENDIM
Nr. 701, datë 9.9.2020

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA
NË VENDIMIN NR. 391, DATË 1.6.2011,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR
MIRATIMIN E STATUTIT TË
SHOQËRISË ‘NXITJA E BIZNESIT
SOCIAL’ SHA”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 8, të ligjit nr. 10376, datë 10.2.2011, “Për krijimin e shoqërisë ‘Nxitja e biznesit social’ sh.a.”, dhe të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në statutin e shoqërisë “Nxitja e biznesit social” sh.a., që i bashkëlidhet vendimit nr. 391, datë 1.6.2011, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

a) Kudo në statut, emërtimi “Këshill administrimi” zëvendësohet me “Këshill Mbikëqyrës”.

b) Në pikën 3, të nenit 11, pas shkronjës “ç” shtohet shkronja “ç/1”, me këtë përmbajtje:

“ç/1. Emërimin dhe shkarkimin e anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës;”.

c) Neni 15 ndryshohet si më poshtë vijon:

“Neni 15
Këshilli Mbikëqyrës

Shoqëria mbikëqyret nga Këshilli Mbikëqyrës, i cili përbëhet nga 5 anëtarë, të cilët emërohen nga Asambleja e Përgjithshme.”.

ç) Shkronja “b”, e nenit 17, shfuqizohet.

d) Neni 18 ndryshohet si më poshtë vijon:

“Neni 18
Kompetencat e Këshillit Mbikëqyrës

a) Të japë direktiva për administratorin për zbatimin e politikave tregtare të shoqërisë;

b) Të kontrollojë e të mbikëqyrë zbatimin e politikave tregtare të shoqërisë nga administratori;

c) Të përgatisë me kërkesë të Asamblesë së Përgjithshme marrjen e masave që janë kompetencë e kësaj të fundit, t’i rekomandojë asaj vendime të vlefshme për t’u marrë, si dhe të zbatojë vendimet e Asamblesë së Përgjithshme;

ç) Të thërrasë mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme, sa herë vlerësohet e nevojshme për interesat e shoqërisë;

d) Të kujdeset që shoqëria të respektojë ligjin dhe standardet e kontabilitetit;

dh) Të shqyrtojë e të kontrollojë librat kontabël, dokumentet dhe aktivet e shoqërisë;

e) Të sigurojë që pasqyrat financiare vjetore, raportet e ecurisë së veprimtarisë, si dhe detyrimet e tjera të raportimit e të publikimit, të detyrueshme në bazë të ligjit apo statutit, të kryhen me saktësi nga administratori. Këto dokumente duhet të miratohen e të nënshkruhen nga të gjithë anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës për t’u paraqitur Asamblesë



së Përgjithshme, së bashku me një raport të Këshillit Mbikëqyrës për miratim dhe një përshkrim për mbikëqyrjen e menaxhimit gjatë vitit financiar;

ë) Të sigurojë që auditimi i librave dhe i regjistrimeve kontabël të kryhet të paktën një herë në vit nga një ekspert kontabël i autorizuar;

f) Të përcaktojë shpërblimin e administratorit;

g) Të vendosë krijimin e bashkëpunimeve tregtare afatgjata dhe propozimin e politikave për themelimin e shoqërive tregtare ose të grupeve të reja;

gj) Të kryejë veprimet e tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.”

dh) Neni 20 ndryshohet si më poshtë vijon:

“Neni 20

Administratori

1. Asambleja e Përgjithshme emëron një person fizik si administrator të shoqërisë, për një periudhë trevjeçare, si dhe merr vendim për revokimin e administratorit.

2. Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës nuk mund të caktohen si administrator. Kufizime të tjera lidhur me emërimin e administratorit parashikohen në pikën 2, të nenit 158, të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar.”

e) Neni 21 ndryshohet si më poshtë vijon:

“Neni 21

Kompetencat e administratorit

Politikat tregtare të shoqërisë administrohen nga shoqëria dhe përfaqësohen nga administratori, i cili mund të ushtrojë të gjitha kompetencat e tij në përputhje me parashikimet e neneve 158, pikat 3 e 5, dhe 159, të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar.”

2. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe shoqëria “Nxitja e biznesit social” sh.a., për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR

Erion Braçe

VENDIM

Nr. 705, datë 9.9.2020

PËR KRITERET E CAKTIMIT TË SHPËRBLIMIT TË ADMINISTRATORIT TË PËRKOHSHËM TË FALIMENTIMIT, RREGULLAT PËR SHPËRBLIMIN E ADMINISTRATORIT TË FALIMENTIMIT, SI DHE KRITERET DHE PËRLLLOGARITJA E SHPËRBLIMIT TË KUJDESTARIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, dhe të neneve 27, pika 3, 48, pika 2, 160, pika 2, të ligjit nr. 110/2016, “Për falimentimin”, me propozimin e ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. TË PËRGJITHSHME

1. Objekt i këtij vendimi është përcaktimi i kriterëve dhe i rregullave për shpërblimin e administratorit të përkohshëm të falimentimit, administratorit të falimentimit, si dhe kujdestarit.

2. Shpërblimi përcaktohet nga gjykata, në përputhje me nenet 27, 48 dhe 160, të ligjit nr. 110/2016, “Për falimentimin”.

3. Në përcaktimin e shumës së shpërblimit për administratorin e përkohshëm të falimentimit, administratorin e falimentimit, si dhe kujdestarin, gjykata, përveç kriterëve të posaçme, merr parasysh kompleksitetin e detyrës, punën e kryer, rezultatet e arritura dhe kujdesin e treguar nga administratori i përkohshëm i falimentimit, administratori i falimentimit, si dhe kujdestari në përmbushjen e detyrave.

II. KRITERET PËR CAKTIMIN E SHPËRBLIMIT TË ADMINISTRATORIT TË PËRKOHSHËM TË FALIMENTIMIT

1. Administratori i përkohshëm i falimentimit, që caktohet nga gjykata përpara fillimit të procedurës së falimentimit, shpërblehet me një shumë jo më të lartë se 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë për 30 (tridhjetë) ditë.

2. Në përcaktimin e shumës së shpërblimit për administratorin e përkohshëm të falimentimit gjykata mban në konsideratë kohëzgjatjen dhe kompleksitetin e detyrës, si dhe llojin e veprimtarisë tregtare që ushtrohet nga debitori.



3. Në rastet kur gjykata cakton një administrator të përkohshëm mbikëqyrës, masa e shpërblimit që caktohet nuk duhet të jetë më e madhe se 70% e masës që do të ishte caktuar në rast se gjykata do të kishte caktuar administrator të përkohshëm falimentimi.

4. Në rastet kur administratori i përkohshëm i falimentimit caktohet nga gjykata për verifikimin e shkakut të hapjes së procedurës së falimentimit, sipas parashikimeve të neneve 19, pika 1, shkronja “c”, dhe 23, pika 2, shkronja “c”, të ligjit nr. 110/2016, “Për falimentimin”, shpërblehet në një shumë jo më të lartë se 100 000 (njëqind mijë) lekë. Në përcaktimin e masës së shpërblimit gjykata merr në konsideratë kompleksitetin dhe kohëzgjatjet e detyrës, si dhe llojin e veprimtarisë tregtare të ushtruar nga debitori.

5. Në rastet kur administratori i përkohshëm nuk realizon detyrën brenda afateve ligjore, gjykata mund të reduktojë masën e shpërblimit.

III. RREGULLAT PËR SHPËRBLIMIN E ADMINISTRATORIT TË FALIMENTIMIT

1. Shpërblimi i administratorit të falimentimit përbëhet nga pagimi i një përqindjeje të shumës së aktivitetit të grumbulluar (masa e falimentimit në përfundim të procedurës së falimentimit), sipas këtyre kufijve:

a) Nga 10% në 12%, kur aktivi nuk është më shumë se 1 500 000 (një milion e pesëqind mijë) lekë;

b) Nga 8% në 10%, kur aktivi është mbi 1 500 000 (një milion e pesëqind mijë) deri në 4 000 000 (katër milionë) lekë;

c) Nga 6,5% në 8,5%, kur aktivi është mbi 4 000 000 (katër milionë) deri në 6 500 000 (gjashtë milionë e pesëqind mijë) lekë;

ç) Nga 5% në 7%, kur aktivi është mbi 6 500 000 (gjashtë milionë e pesëqind mijë) deri në 13 000 000 (trembëdhjetë milionë) lekë;

d) Nga 3,5% në 5,5%, kur aktivi është mbi 13 000 000 (trembëdhjetë milionë) deri në 65 000 000 (gjashtëdhjetë e pesë milionë) lekë;

dh) Nga 2% në 4%, kur aktivi është mbi 65 000 000 (gjashtëdhjetë e pesë milionë) deri në 130 000 000 (njëqind e tridhjetë milionë) lekë;

e) Nga 1,5% në 2,5%, kur aktivi është mbi 130 000 000 (njëqind e tridhjetë milionë) deri në 250 000 000 (dyqind e pesëdhjetë milionë) lekë;

ë) Nga 1% në 1,5%, kur aktivi është mbi 250 000 000 (dyqind e pesëdhjetë milionë) deri në 500 000 000 (pesëqind milionë) lekë;

f) Nga 0,6% në 1,2%, kur aktivi tejkalon 500 000 000 (pesëqind milionë) lekë.

2. Në përcaktimin e përqindjes së shpërblimit të administratorit, në rastet e vendimit për likuidim, sipas pikës 1, të këtij kreu, gjykata mban parasysh shumën e aktivitetit të grumbulluar, numrin e kreditorëve, llojin e biznesit dhe kompleksitetin e detyrës.

3. Shpërblimi i administratorit të falimentimit, në rastet e vendimit për riorganizim, caktohet nga gjykata me një shumë mujore, jo më pak se 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, të caktuar deri në miratimin ose jo të planit të riorganizimit. Në përcaktimin e masës së shpërblimit të administratorit të falimentimit, në rastet e vendimit për riorganizim, gjykata mban parasysh menaxhimin e biznesit, numrin e kreditorëve, llojin e biznesit dhe kompleksitetin e detyrës.

4. Shpërblimi, sipas parashikimeve në pikat 1 dhe 3, të këtij kreu, do të rritet me 10%, llogaritur mbi vlerën takuese sipas këtyre pikave, në rastet kur:

a) ka më shumë se 200 kreditorë;

b) ka më shumë se 3 njësi prodhimi, në qytete të ndryshme;

c) rasti paraqet kompleksitet të veçantë ligjor, sipas vlerësimit të bërë nga gjykata.

5. Administratorët e falimentimit kanë të drejtën e përfitimit të një tarife suksesi, në përputhje me parashikimet e shkronjës “ç”, të pikës 3, të nenit 48, të ligjit nr. 110/2016, “Për falimentimin”, si dhe me parashikimet e këtij vendimi. Tarifa e suksesit të administratorëve të falimentimit i shtohet tarifës bazë të shpërblimit të përfituar prej tij dhe nuk mund të jetë më shumë se:

a) 25% e tarifës bazë së shpërblimit, kur administratorit i jepet detyra e menaxhimit të biznesit pas miratimit të planit të riorganizimit;

b) 20% e tarifës bazë së shpërblimit, nëse miratohet një plan riorganizimi;

c) 15% e tarifës bazë së shpërblimit, nëse biznesi, një ose më shumë njësi biznesi që përfaqësojnë më shumë se gjysmën e vlerës së masës së falimentimit, shiten ose transferohen si aktivitete që vazhdojnë veprimtarinë.

6. Me vendim të gjykatës, administratorit të falimentimit mund t'i parapaguhet deri në 20% të



shumës së shpërblimit total që i përket, përpara shpërndarjes përfundimtare kundrejt kreditorëve të falimentimit, në përputhje me pikën 4, të nenit 139, të ligjit nr. 110/2016, “Për falimentimin”.

7. Në rast të mbarimit të veprimtarisë së administratorit të falimentimit, për shkak dorëheqjeje apo shkarkimi nga detyra, përpara përfundimit të procedurës së falimentimit, ai gëzon të drejtën e përfitimit të shpërblimit, proporcionalisht me punën e kryer.

8. Në rast të prishjes së vendimit për çeljen e procedurës së falimentimit, administratori gëzon të drejtën e përfitimit të shpërblimit për punën e kryer deri në atë moment.

IV. KRITERET DHE PËRLLOGARITJA E SHPËRBLIMIT TË KUJDESTARIT

Shpërblimi i kujdestarit caktohet nga gjykata, duke iu referuar të ardhurave të debitorit individ në procedurë falimentimi, shpenzimeve të jetesës së tij, si dhe në bazë të kohëzgjatjes së detyrës së kujdestarit dhe kompleksitetit të saj. Në çdo rast, shpërblimi i kujdestarit nuk mund të jetë me pak se 20 000 (njëzet mijë) lekë në muaj. Në rastet kur kujdestari ngarkohet nga gjykata me detyra të posaçme, shpërblimi i tij nuk mund të jetë me shumë se 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë.

V. DISPOZITAT E FUNDIT

1. Vendimi nr. 197, datë 13.4.2007, i Këshillit të Ministrave, “Për kushtet dhe kriteret e përcaktimit të masës së shpërblimit dhe të rimbursimit të shpenzimeve të administratorit të falimentimit”, shfuqizohet.

2. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë dhe Agjencia Kombëtare e Falimentimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

VENDIM

Nr. 707, datë 9.9.2020

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 182, DATË 26.2.2020, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN E MASËS, TË KRITEREVE, PROCEDURAVE E DOKUMENTACIONIT PËR VLERËSIMIN DHE PËRFITIMIN E PAGESËS PËR PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUARA, SI DHE TË NDIHMËSIT PERSONAL”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 17, pika 1, të ligjit nr. 57, datë 18.7.2019, “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”, dhe të nenit 15, të ligjit nr. 8626, datë 22.6.2000, “Statusi i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 182, datë 26.2.2020, të Këshillit të Ministrave, bëhen shtesat dhe ndryshimet, si më poshtë vijon:

1. Në kreun II bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

a) pas pikës 1 shtohen pikat 1.1 dhe 1.2, me këtë përmbajtje:

“1.1. Personi që vlerësohet për herë të parë për aftësi të kufizuara, përveç vlerësimit të dosjes paraqitet edhe personalisht para KMCAP-së së nivelit të parë.

1.2. Rivlerësimi i personave me aftësi të kufizuara bëhet bazuar në dokumentacionin e dosjes së paraqitur, pa praninë fizike të personit me aftësi të kufizuara. Komisioni, në rastet kur nuk mund të marrë vendim vetëm bazuar në dokumentacionin e paraqitur për rivlerësim, ka të drejtë të thërrasë personin me aftësi të kufizuara për t’u paraqitur fizikisht në komision. Paraqitja në komision do të bëhet në një nga mbledhjet e muajit pasardhës, por jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga data që do të realizohet vlerësimi me dosje. Njoftimi formal për paraqitje në komision do të bëhet përmes administratorit shoqëror të njësisë



administrative, nën juridiksionin e të cilit ka vendbanimin personi.”.

b) pika 9 shfuqizohet.

2. Në fund të kreut II shtohet kreu II/I “Rregullat procedurale të vlerësimit nga KMCAP-ja”, me këtë përmbajtje:

“II/I Rregullat procedurale të vlerësimit nga KMCAP-ja

1. Komisioni Mjekësor i Caktimit të Aftësisë për Punë (KMCAP), që bën vlerësimin e personave me aftësi të kufizuara, është organ mjekësor dhe ligjor që e ushtron aktivitetin e tij pranë Shërbimit Social Shtetëror (SHSSH) dhe përgjigjet para tij për aktivitetin që kryen.

2. Për të shqyrtuar dokumentacionin e vlerësimit/rivlerësimit dhe për të vlerësuar për herë të parë personat që kërkojnë të përfitojnë pagesë të aftësisë së kufizuar, KMCAP-të e nivelit të parë mbledhen jo më pak se 3 (tre) herë në muaj, ndërsa KMCAP-të eprore jo më pak se një herë në muaj. Për këtë qëllim, anëtarët e KMCAP-ve, për ditët që janë në komisione lirohen nga detyra e përditshme dhe punojnë pranë organeve të Shërbimit Social Shtetëror.

3. Anëtarët e KMCAP-ve njohin legjislacionin në fuqi, kriteret mjekësore për vlerësimin e personave me aftësi të kufizuara, si dhe i zbatojnë ato drejt, saktë e me përgjegjësi profesionale.

4. Gjatë zhvillimit të seancës, anëtarët e KMCAP-ve studiojnë praktikën me dokumentacionin e plotësuar, vlerësojnë rastin, gjykojnë nëse plotësohen ose jo kushtet ligjore për përfitim, marrin të dhëna për ecurinë e sëmundjes dhe kohën e fillimit të trajtimit dhe në bazë të këtyre të dhënave marrin vendim mbi grupin e përfitimit:

a) grupi i parë, në të cilën vlerësohen personat me aftësi të kufizuara që kanë nevojë për përkujdesje;

b) grupi i dytë, në të cilën vlerësohen personat me aftësi të kufizuara që nuk kanë nevojë për përkujdesje;

c) afatet e përfitimit për secilin grup;

ç) nevojën për përfitime të tjera sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi. Pas përfundimit të vlerësimit, dosjet e përfituesve të shoqëruar me njoftimin për vendimin për çdo person, dërgohen pranë drejtorive rajonale të Shërbimit Social Shtetëror, për të kryer veprimet

sipas përcaktimeve në pikën 9, të kreut IV, të këtij vendimi.

5. KMCAP-ja e nivelit të parë ka këto detyra:

a) cakton drejt dhe në përputhje me dokumentacionin shëndetësor dhe gjendjen shëndetësore të individëve që aplikojnë për herë të parë, si dhe në mbështetje të kriterëve mjekësore, përfitimin e pagesave të aftësisë së kufizuar;

b) cakton datën e paraqitjes pranë KMCAP-së së aplikuesit për rastet që do të vlerësohen për herë të parë;

c) vlerëson dokumentacionin e drejtimit për në KMCAP “fletë drejtimin” i cili kur është lëshuar nga institucionet mjekësore të specializuara me shtretër (spitali) përmbajnë të gjitha rubrikat të plotësuar nga mjeku kurues sipas formatit, duke përfshirë dhe ID-n e personit dhe të nënshkruar nga mjeku kurues, shefi i pavionit apo klinikës, shefi i shërbimit dhe drejtuesit e institucionit. Pajisja ose jo me këtë dokument është vendosur në vizitën e përgjithshme ose në konferencën klinike të drejtuar nga shefi i klinikës ose shefi i shërbimit. Vendimi i marrë është i pasqyruar edhe në kartelën klinike të firmosur nga mjeku kurues, shefi i pavionit apo shefi i klinikës dhe në mungesë të tij shefi i shërbimit. Lëshohet nga komisionet mjekësore vetëm për rastet që nuk përbejnë trajtim në institucione me shtretër të tilla si: sëmundje të syve, kirurgjikale, ortopedike, gjendje pas djegies dhe shëndetit mendor (raste që nuk përbejnë trajtim në institucione me shtretër);

ç) vlerëson dokumentacionin e lëshuar nga specialistët, konsultat ose spitali, për rastet që rivlerësohen për aftësi të kufizuara me “epikrizë përcjellëse”, e cila është plotësuar saktë, qartë dhe me përgjegjësi, duke evidentuar gjendjen shëndetësore të personit me aftësi të kufizuara nga vlerësimi i fundit deri në rivlerësimin e radhës;

d) vlerëson analizat dhe ekzaminimet, me përgjigje zyrtare të interpretuara nga mjeku specialist, të cilat janë të domosdoshme, për evidentimin e plotë të gjendjes shëndetësore të individit dhe që shoqërojnë fletën e drejtimit për në KMCAP dhe epikrizën përcjellëse;

dh) vlerëson dokumentacionin kur personi pretendon se ka një gjendje shëndetësore të rënduar, për të cilën nevojitet pajisja me “Fletëdrejtimi për në KMCAP”;

e) vlerëson shkakun e aftësisë së kufizuar nga sëmundje e përgjithshme, sëmundje të shëndetit



mendor, përfitimet nga statusi paratetraplegjik, kohën e fillimit të pagesës, periudhën e përfitimit, si edhe afatin e rivlerësimit;

ë) shqyrton rastin brenda 30 (tridhjetë) ditëve pasi është marrë me procesverbal prej protokollit nga mjeku i Shërbimit Social Shtetëror dhe pasi ky i fundit ka kryer verifikimet e nevojshme të dokumentacionit mjekësor, për rastet që vlerësohen për herë të parë;

f) rivlerëson 2 (dy) muaj para përfundimit të afatit që është vendosur në vendimin e fundit, dosjen që përmban dokumentacionin e plotë ekzistues, si dhe epikrizën përcjellëse, e cila shoqërohet me analiza dhe ekzaminime, me përgjigje zyrtare të interpretuara nga mjeku specialist, që janë të domosdoshme për evidentimin e plotë të gjendjes shëndetësore, të marrë në dorëzim me procesverbal nga mjeku i Shërbimit Social Shtetëror;

g) cakton pagesën për aftësinë e kufizuar, për periudhën e përfitimit, mbështetur në kriteret diagnostike të miratuara për çdo diagnozë;

gj) propozon drejtimet për riaftësimin profesional të personit me aftësi të kufizuara;

h) kryen studime mbi gjendjen dhe ecurinë, si edhe problematikat e aftësisë së kufizuar në qark.

6. Dosjet e personave me aftësi të kufizuara, që nuk përmbajnë dokumentacionin për rivlerësim në KMCAP në datën e rivlerësimit, ruajnë të drejtën e rishqyrtimit gjatë periudhës tremujore në vazhdim. Kur dokumentacioni paraqitet brenda kësaj periudhe, e drejta e përfitimit ruhet edhe për periudhën e rapambetur.

7. Kur dokumentacioni për rivlerësim nuk paraqitet në KMCAP edhe gjatë kësaj periudhe, KMCAP-ja e konsideron dosjen të mbyllur dhe praktika duhet të nisë si procedurë vlerësimi për herë të parë me detyrimin e paraqitjes në komision të individit.

8. Procesi i vlerësimit/rivlerësimit për përfitimin e pagesës së aftësisë së kufizuar bëhet në zbatim të kriterëve mjekësorë dhe diagnostike, periudhës së riaftësimit, për të cilën afatet e rivlerësimit shtrihen në kohë sipas kriterëve mjekësorë.

9. KMCAP-ja eprore ka këto detyra:

a) shqyrton dhe zgjidh kërkesat e personave me aftësi të kufizuara, që ankimojnë brenda 30 (tridhjetë) ditëve vendimet e KMCAP-ve të nivelit të parë, si edhe shqyrton dhe zgjidh rastet e

dërguara me divergjencë nga KMCAP-ja e nivelit të parë;

b) studion praktikën e dërguara nga Kontrolli i Shërbimit Social Shtetëror, merr masa për plotësimin e tyre, thërret dhe viziton rastin në mbledhjen e radhës dhe në varësi të problematikave të konstatuara dhe gjendjes shëndetësore merr vendim për vlerësimin e aftësisë së kufizuar;

c) sipas natyrës dhe rëndësisë së shkeljeve urdhëron KMCAP-në e nivelit të parë që të rivlerësojë përfituesit dhe të rregullojë vendimet, ku caktimi i pagesës së aftësisë së kufizuar ka qenë i kundërligjshëm ose organizon vetë një seancë të veçantë për rikontrollin e tyre. Në këto raste, KMCAP-ja, për çdo individ që do të rivlerësojë, merr vendim të ri për vlerësimin e aftësisë së kufizuar;

ç) kryen studime mbi gjendjen dhe ecurinë e sëmundshmërisë dhe cakton drejtimet e rrugët për përmirësimin e treguesve.

10. Vendimi i KMCAP-së së nivelit të parë dhe KMCAP-së eprore është dokumenti bazë juridik-mjekësor-administrativ që njihet të drejtën për përfitime të aftësisë së kufizuar. Ai plotësohet saktë, qartë, me përgjegjësi, sipas kërkesave të formatit, me shkrim të lexueshëm, pa korrigjime, vërtetohet me emrin dhe mbiemrin e anëtarëve të KMCAP-së, nënshkrimin e tyre, si dhe vuloset me vulën e komisionit. Vendimi ka fuqi ligjore ekzekutive kur është i nënshkruar nga të gjithë anëtarët e KMCAP-së.

11. Në rastet kur ndërmjet anëtarëve të komisionit ka mendime të ndryshme, vendimi merret me divergjencë dhe anëtari që nuk është dakord me të tjerët argumenton vendimin me arsyet e divergjencës. Në këto raste, vendimi nuk ka fuqi ligjore ekzekutive dhe së bashku me dosjen dërgohet zyrtarisht në KMCAP-në eprore të specializuar.

12. Kur anëtarët e KMCAP-së eprore të specializuar kanë mendime të kundërta, vendimi merr formën e prerë me shumicë votash.

13. Vendimi i KMCAP-së eprore të specializuar nuk mund të ndryshohet nga KMCAP-ja e nivelit të parë. Në ato raste kur KMCAP-ja e nivelit të parë gjykon se kërkuesi paraqet gjendje shëndetësore të rënduar dhe bën objekt për të ndryshuar kushtet e përfitimit, ai merr vendim duke argumentuar edhe arsyen e këtij ndryshimi. Në këto



raste, pavarësisht vendimit të KMCAP-së së nivelit të parë, vendimi do të hyjë në fuqi vetëm pas miratimit të KMCAP-së eprore të specializuar.

14. Vendimi, në çdo rast, plotësohet gjatë mbledhjes. Krahas plotësimit të vendimit, plotësohet edhe vërtetimi, i cili përmban shkurtimisht të dhënat kryesore të vendimit.”.

3. Në kreun IV bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

a) pika 6 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“6. Administratori shoqëror, me marrjen e dokumentacionit nga institucioni shëndetësor, e dërgon atë brenda 24 (njëzet e katër) orëve, me procesverbal, pranë mjekut të Shërbimit Social Shtetëror, dhe listën emërore të personave që do të vlerësohen apo do të rivlerësohen, pranë KMCAP-së. Mjeku i Shërbimit Social Shtetëror verifikon nëse dosjet e paraqitura janë të plotësuara me dokumentacionin përkatës dhe, më pas, i përcjell ato në KMCAP. Mjeku mban regjistrin e personave me aftësi të kufizuara, sipas pikës 1, të kreut I, të këtij vendimi.”.

b) pas pikës 11 shtohet pika 12, me këtë përmbajtje:

“12. Dosja me dokumentacionin e plotë të personit me aftësi të kufizuara sistemohet në praktikën e tij të veçantë, mbahet dhe ruhet në njësinë administrative/bashkinë ku ka vendbanimin individuali.”.

II. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, të gjitha organet e administratës shtetërore shëndetësore dhe sociale dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

VENDIM

Nr. 708, datë 9.9.2020

PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E AUTORITETIT KOMBËTAR TË USHQIMIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të neneve 61, pika 7, 64, pikat 2 e 5, dhe 65, pika 3, të ligjit nr. 9863, datë 28.1.2008, “Për ushqimin”, të ndryshuar, si dhe të nenit 6, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, me propozimin e ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, këtu e në vijim AKU, si person juridik publik buxhetor, në varësi të ministrit përgjegjës për ushqimin, këtu e në vijim ministri, me seli në Tiranë. AKU-ja financohet nga buxheti i shtetit dhe burime të tjera të brendshme ose donacione.

2. Misioni i AKU-së është të garantojë sigurinë dhe cilësinë e ushqimeve e ushqimeve për kafshë në Republikën e Shqipërisë, nëpërmjet kryerjes së veprimtarive inspektuese, teknike dhe shkencore në këtë fushë.

3. AKU-ja e ushtron veprimtarinë e saj në të gjithë territorin e vendit dhe ka fushë përgjegjësie sigurinë e ushqimit dhe ushqimit për kafshë në të gjithë zinxhirin e saj, sigurinë e shëndetit të kafshëve në pikat kufitare dhe shëndetit të bimëve e të produkteve bimore kur ato kanë dalë në treg.

II. PËRGJEGJËSITË FUNKSIONALE

AKU-ja ka përgjegjësi:

a) të ofrojë mendim shkencor për ushqimin dhe ushqimin për kafshë, vlerat ushqimore të ushqimit dhe të përgatitës standardet në këtë fushë;

b) të organizojë punën për kryerjen e veprimtarisë inspektuese në përputhje me fushat e saj të përgjegjësisë;

c) të organizojë punën për analizimin, vlerësimin dhe komunikimin e riskut për ushqimin dhe ushqimin për kafshë;

ç) të organizojë punën për trajnimin e certifikimin e inspektorëve të kontrollit të ushqimit



dhe ushqimit për kafshë, mbrojtjes së bimëve dhe inputeve bujqësore.

III. ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI

1. AKU-ja e shtrin veprimtarinë në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe organizohet në:

a) nivel qendror, nëpërmjet Drejtorisë së Përgjithshme;

b) nivel rajonal, nëpërmjet drejtorive rajonale në qarqe.

2. Struktura dhe organika e AKU-së miratohen me urdhër të Kryeministrit, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore.

3. AKU-ja drejtohet nga drejtori i Përgjithshëm, i cili përgjigjet te ministri dhe përfaqëson AKU-në në marrëdhënie me të tretët.

4. Drejtori i Përgjithshëm i AKU-së emërohet dhe lirohet nga Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit. Drejtori i Përgjithshëm duhet të plotësojë kriteret e mëposhtme:

a) të jetë shtetas shqiptar;

b) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;

c) të ketë diplomë të nivelit “Master shkencor” apo “Master profesional” të përfutur në fund të studimeve të ciklit të dytë me 120 kredite dhe me kohëzgjatje normale 2 vite akademike, ose të barasvlershme me to, sipas legjislacionit për arsimin e lartë, në ekonomi, drejtësi ose shkenca teknike që lidhen me fushat ku gjen zbatim legjislacioni i ushqimit;

ç) të ketë përvojë pune, të paktën 5 (pesë) vjet në profesion apo në fusha ku gjen zbatim legjislacioni i ushqimit;

d) të shquhet për aftësi profesionale dhe figurë të pastër etiko-morale;

dh) ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga puna, që nuk është shuar sipas legjislacionit në fuqi;

e) të mos jetë dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale.

5. Drejtori i Përgjithshëm lirohet ose shkarkohet nga detyra kur:

a) plotësohet mosha për pensionin e plotë të pleqërisë;

b) dënohet me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje;

c) deklarohet i paaftë për punë nga komisioni kompetent mjekësor;

ç) gjendet në një situatë të konfliktit të vazhdueshëm të interesit;

d) jep dorëheqjen nga detyra;

dh) kryen shkelje të rënda gjatë kryerjes së detyrës.

6. Pranë Drejtorisë së Përgjithshme të AKU-së funksionojnë:

a) bordi i AKU-së, i cili mbikëqyr veprimtarinë e AKU-së dhe organizohet e funksionon në bazë të ligjit përkatës për ushqimin dhe të kreut IV, të këtij vendimi;

b) komiteti shkencor dhe panelet shkencore, të cilat kanë përgjegjësitë, përbërjen dhe të drejtat, si dhe kryejnë detyrat e përcaktuara në legjislacionin në fuqi.

7. Drejtoria e Përgjithshme, për ushtrimin e kompetencave të përcaktuara në legjislacionin në fuqi për ushqimin dhe përveç sa është parashikuar në të, kryen detyrat e mëposhtme:

a) koordinon planifikimin dhe kryerjen e kontrollit zyrtar të ushqimeve, ushqimeve për kafshë, inputeve bujqësore, veprimtarive prodhuese të duhan-cigareve, si dhe për kontrollin në pikën e inspektimit kufitar të shëndetit të kafshëve, produkteve mjekësore veterinarë dhe mbrojtjen e bimëve;

b) unifikon praktikat e kontrollit zyrtar të ushqimeve, ushqimeve për kafshë, inputeve bujqësore, veprimtarive prodhuese të duhan-cigareve, si dhe për kontrollin në pikën e inspektimit kufitar të shëndetit të kafshëve, produkteve mjekësore veterinarë dhe produktet e mbrojtjes së bimëve;

c) drejton dhe bashkërendon veprimtarinë e laboratorëve të autorizuar të sistemit të kontrollit zyrtar të ushqimeve dhe ushqimeve për kafshë;

ç) siguron kryerjen e analizave nga laboratorë të tjerë të akredituar, brenda ose jashtë vendit, në rastin e pamundësisë së kryerjes së tyre nga laboratorët e autorizuar të kontrollit zyrtar;

d) drejton procesin e vlerësimit të riskut në fushën e sigurisë së ushqimeve dhe ushqimeve për kafshë;

dh) kryen studime shkencore të nevojshme dhe përgatit mendimin shkencor paraprak për nxjerrjen në treg të OMGJ-ve dhe/ose ushqimeve të reja;

e) siguron mbështetje teknike e administrative për të siguruar veprimtarinë e komitetit shkencor dhe të paneleve shkencore;



ë) përgatit raportin vjetor për veprimtarinë e AKU-së;

f) përgatit planin e punës dhe buxhetin afatshkurtër e afatmesëm të AKU-së;

g) administron dhe menaxhon për Drejtorinë e Përgjithshme dhe drejtoritë rajonale burimet pasurore, njerëzore, çështjet ligjore, automatizimin e proceseve të brendshme operative;

gj) mbikëqyr buxhetin, administrimin financiar, mbajtjen e kontabilitetit dhe kryerjen e auditimit të brendshëm.

8. Drejtori i Përgjithshëm i AKU-së, përveç sa është parashikuar në ligjin përkatës për ushqimin, kryen detyrat e mëposhtme:

a) raporton te ministri dhe bordi i AKU-së, në mënyrë shkresore, për veprimtarinë e institucionit, jo më pak se një herë në çdo 3 muaj, për çështje të aktivitetit të përgjithshëm të AKU-së dhe sa herë i kërkohet nga ministri për çështje specifike;

b) i paraqet bordit të AKU-së për vlerësim objektivat strategjike, planin kombëtar të kontroleve zyrtare në bazë risku dhe marrjen e mostrave për ushqimin, ushqimin për kafshë, mbrojtjen e bimëve dhe inputeve bujqësore;

c) përcakton objektivat vjetorë të AKU-së, në përputhje me objektivat strategjike të miratuar nga ministri dhe harton planin vjetor të punës së institucionit;

ç) drejton procesin e planifikimit buxhetor dhe të raportit vjetor të punës, të cilat ia paraqet për vlerësim bordit të AKU-së;

d) përgatit dhe përcjell për miratim pranë ministrit rregulloren që përcakton metodat e brendshme të punës dhe sjelljen e personelit;

dh) përgatit kërkesat e veçanta të vendit të punës për rekrutimin e nëpunësve/punonjësve të AKU-së;

e) autorizon shpërndarjen e informacionit për publikun;

ë) përcakton nëpunësit që janë pjesë e sekretariatit teknik për komisionin e gjobave pranë ministrisë përgjegjëse për ushqimin;

f) nxjerr akte të brendshme për menaxhimin administrativ, financiar, të burimeve njerëzore dhe akte të tjera të brendshme të detyrueshme për nëpunësit e AKU-së, për realizimin e funksioneve të këtij institucioni;

g) nënshkruan marrëveshjet e bashkëpunimit me institucionet e tjera publike shqiptare apo të huaja, në përputhje me parashikimet ligjore;

gj) kërkon thirrjen e mbledhjeve të bordit dhe merr pjesë në to;

h) autorizon, me shkrim, delegimin e pjesshëm apo të plotë të kompetencave, në rast të mungesës së tij;

i) gjatë kontrollit në pikat doganore, para daljes së vendimit përfundimtar të inspektorit ose të grupit të kontrollit, miraton kërkesën e argumentuar të operatorëve për rikontroll, në laboratorë të akredituar në vendet e Bashkimit Evropian;

j) emëron nëpunësit dhe personelin e nevojshëm, në përputhje me Kodin e Punës;

k) çdo detyrë tjetër të ngarkuar nga legjislacioni në fuqi dhe ministri.

9. Në Drejtorinë e Përgjithshme të AKU-së funksionon Komisioni i Shqyrtimit të Masave Administrative, i përbërë nga 5 (pesë) anëtarë, i cili ka këtë përbërje:

a) drejtori i Përgjithshëm i AKU-së, kryetar i komisionit;

b) një përfaqësues i njësisë që mbulon çështjet juridike, sekretar i komisionit;

c) një përfaqësues i njësisë përkatëse që mbulon çështjen e inspektimit që ankimohet;

ç) dy specialistë nga njësitë e tjera të Drejtorisë së Përgjithshme.

Lista emërore e komisionit miratohet me urdhër të drejtorit të Përgjithshëm.

10. Komisioni i Shqyrtimit të Masave Administrative ka kompetenca të përgjithshme dhe shqyrton të gjitha ankimet administrative, me përjashtim të ankimeve administrative ndaj vendimeve që kanë gjoba/sanksione financiare mbi 300 000 (treqind mijë) lekë, të cilat shqyrtohen nga Komisioni i Shqyrtimit të Masave Administrative, në ministrinë përgjegjëse për ushqimin.

11. Drejtoritë rajonale drejtohen nga kryeinspektori rajonal dhe e ushtrojnë veprimtarinë e tyre në territorin e qarkut që mbulojnë. Me urdhër të drejtorit të Përgjithshëm, punonjës të drejtorisë rajonale, për një periudhë kohe të caktuar në urdhër dhe sipas detyrave të përcaktuara, mund të ushtrojnë veprimtarinë e tyre edhe në territorin e një qarku tjetër, në bashkëpunim me drejtorinë rajonale përkatëse që mbulon territorin e atij qarku. Ushtrimi i detyrave në territorin e një qarku tjetër bëhet për shkak të numrit të pamjaftueshëm të punonjësve të kësaj drejtorie ose njohurive



specifike të punonjësve që do të ushtrojnë veprimtarinë.

12. Drejtoritë rajonale kanë detyrat e mëposhtme:

a) kryejnë kontrollin zyrtar të ushqimeve, të ushqimeve për kafshë, të inputeve bujqësore, të veprimtarive prodhuese të duhan-cigareve dhe kontrollin zyrtar në pikën e inspektimit kufitar të shëndetit të kafshëve, produkteve mjekësore veterinarë dhe produktet e mbrojtjes së bimëve;

b) kryejnë kontrollet paraprake për përmbushjen e kërkesave tekniko-teknologjike, higjieno-sanitare, fitosanitare dhe veterinarë, verifikimin e dokumentacionit të nevojshëm për regjistrimin dhe licencimin e operatorëve të biznesit të ushqimit, ushqimit për kafshë dhe produktet e mbrojtjes së bimëve dhe inputeve bujqësore;

c) mbledhin dhe organizojnë informacion bazë, cilësor dhe sasior, në fushën e sigurisë së ushqimeve, të ushqimeve për kafshë, të mbrojtjes së bimëve dhe të inputeve bujqësore, të shëndetit të kafshëve, të produkteve mjekësore veterinarë dhe e përcjellin në Drejtorinë e Përgjithshme të AKU-së, sipas kërkesave të saj;

ç) ndalojnë, përkohësisht ose në mënyrë të përhershme, veprimtarinë e operatorëve të biznesit të ushqimit dhe të ushqimit për kafshë në fazat e prodhimit, të përpunimit, të shpërndarjes dhe të tregtimit të ushqimit apo të ushqimit për kafshë, kur vërtetohet se ushqimi apo ushqimi për kafshë dhe operatorët përkatës të biznesit nuk plotësojnë standardet e sigurisë ushqimore, të përcaktuara në legjislacionin në fuqi;

d) përgatisin raportin vjetor për veprimtarinë e drejtorisë rajonale përkatëse, sipas formatit dhe udhëzimeve të Drejtorisë së Përgjithshme të AKU-së.

13. Kryeinspektori rajonal përgjigjet te drejtori i Përgjithshëm i AKU-së dhe është përgjegjës për cilësinë, integritetin dhe efektivitetin e veprimtarisë inspektuese të drejtorisë rajonale dhe të stafit të saj, si dhe e përfaqëson atë me të tretët, në nivelin e qarkut përkatës. Kryeinspektori rajonal ka këto detyra:

a) organizon veprimtarinë e drejtorisë rajonale;

b) lëshon autorizimin e inspektimit, në përputhje dhe në bazë të programit të miratuar të inspektimit apo të akteve/urdhrave të nxjerrë nga drejtori i Përgjithshëm;

c) vendos për shtyrjen e kohëzgjatjes së autorizimit të inspektimit në përputhje me legjislacionin në fuqi për inspektimin;

ç) vendos për zëvendësimin e inspektorëve gjatë inspektimit, sipas ligjit;

d) çdo detyrë tjetër të ngarkuar nga legjislacioni në fuqi dhe drejtori i Përgjithshëm.

14. Pikat e inspektimit kufitar janë në varësi të drejtorive rajonale përkatëse të AKU-së dhe kryejnë kontrollin e ngarkesave të ushqimit, të ushqimit për kafshë, të mbrojtjes së bimëve dhe të inputeve bujqësore, të shëndetit të kafshëve, produkteve mjekësore veterinarë, duhanit dhe produktet e tij, të cilat hyjnë, dalin ose tranzitojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

15. Laboratorët rajonalë janë në varësi të Drejtorisë së Përgjithshme të AKU-së dhe mbështesin veprimtarinë e drejtorive rajonale. Në laboratorët rajonalë kryhet analizimi laboratorik për kontrollin zyrtar të ushqimit, të ushqimit për kafshë.

16. Marrëdhëniet e punës së nëpunësve dhe punonjësve administrativë të AKU-së rregullohen në bazë të dispozitave të Kodit të Punës.

17. Ministri, me propozimin e drejtorit të Përgjithshëm, miraton rregulloren që përcakton metodat e brendshme të punës dhe sjelljen e personelit.

18. Drejtoria e Përgjithshme e AKU-së ka stemën, logon dhe vulën e vet zyrtare. Stema e Drejtorisë së Përgjithshme përbëhet nga stema e Republikës së Shqipërisë, me shënimet “Republika e Shqipërisë, Ministria ... (emri i ministrisë përgjegjëse për ushqimin), Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, Drejtoria e Përgjithshme”.

19. Drejtoritë Rajonale të AKU-së kanë stemën, logon dhe vulën e tyre zyrtare. Stema e secilës drejtori rajonale përbëhet nga stema e Republikës së Shqipërisë, me shënimet “Republika e Shqipërisë, Ministria ... (emri i ministrisë përgjegjëse për ushqimin), Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, Drejtoria Rajonale e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit (emri i qarkut/qytetit ku ka selinë drejtorie)”.

20. Vula e Drejtorisë së Përgjithshme të AKU-së dhe vula e secilës drejtori rajonale ka formën dhe elementet e përcaktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave për rregullat e prodhimit, të administrimit, të kontrollit dhe të ruajtjes së vulave



zyrtare. Vulat prodhohen, administrohen dhe ruhen në përputhje me legjislacionin në fuqi.

IV. ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I BORDIT TË AKU-së

1. Anëtar i bordit emërohet shtetasi shqiptar, që plotëson kriteret e mëposhtme:

a) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;

b) të ketë diplomë të nivelit “Master shkencor” apo “Master profesional” të përfituar në fund të studimeve të ciklit të dytë me 120 kredite dhe me kohëzgjatje normale 2 vite akademike ose të barasvlershme me to, sipas legjislacionit për arsimin e lartë, në ekonomi, drejtësi ose shkenca teknike që lidhen me fushat ku gjen zbatim legjislacioni i ushqimit;

c) të ketë përvojë pune të paktën 5 (pesë) vjet në administratën shtetërore, për anëtarët e bordit të emëruar si përfaqësues të ministrive të linjës;

ç) të jetë personalitet i shquar i fushës ku vepron, për anëtarët e bordit të emëruar si person publik në fushën e medias, përfaqësues të shoqatës së konsumatorëve dhe përfaqësues të shoqatës së agrobiznesit;

d) të mos jetë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale;

dh) ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga puna, që nuk është shuar sipas legjislacionit në fuqi;

e) të mos jetë në konflikt interesi me detyrat, funksionet apo veprimtarinë e tij shtetërore apo private.

2. Anëtarët e bordit përfaqësues të ministrive, përveç sa është përcaktuar në pikën 1, të këtij kreu, duhet të jenë nëpunës të njëjësive organizative që lidhen me fushën e veprimtarisë së AKU-së në ministrinë përkatëse dhe i propozohen ministrit përgjegjës për ushqimin nga ministri përkatës.

3. Bordi, në funksion të përmbushjes së përgjegjësisë të tij të përcaktuara në ligjin përkatës për ushqimin, kryen detyrat e mëposhtme:

a) shqyrton dhe jep vlerësimin e tij për objektivat strategjike, projektbuxhetin dhe planin kombëtar të kontroleve zyrtare në bazë risku dhe atë të marrjes së mostrave për ushqimin, ushqimin për kafshë, mbrojtjes së bimëve dhe inputeve bujqësore, përpara dërgimit të tyre për miratim, sipas legjislacionit në fuqi në ministrinë përgjegjëse për ushqimin;

b) shqyrton dhe jep vlerësimin e tij për raportin vjetor të veprimtarisë së AKU-së;

c) shqyrton dhe jep vlerësimin e tij për projektplanin e menaxhimit të krizave të propozuara nga AKU-ja;

ç) nëpërmjet anëtarëve të tij, ndihmon në bashkërendimin e punës me ministrinë e linjës dhe institucionet e tjera, të përfaqësuara në bord.

4. Anëtarët e bordit caktohen nga ministri, në bazë të kandidaturave të paraqitura nga organet e emërtesës, nga sektorë që lidhen me fushën e veprimtarisë së AKU-së.

5. Anëtarët e bordit shkarkohen nga kjo detyrë nga organi i emërtesës dhe mandati i tyre përfundon në rastet kur:

a) anëtari i bordit, përfaqësues i një ministrie linje, nuk është më në marrëdhënie pune me këtë ministri;

b) anëtari i bordit, i zgjedhur nga radhët e profesorëve të fushave të ushqimit, ushqimit për kafshë, veterinarisë dhe mbrojtjes së bimëve nga universitetet, nuk është më në marrëdhënie pune me universitetin përkatës;

c) detyra si anëtar i bordit është në konflikt interesi me detyrën, veprimtarinë apo funksionin që ky anëtar ka në sektorin shtetëror apo privat;

ç) anëtari i bordit nuk merr pjesë në mënyrë të përsëritur dhe pa shkak të ligjshëm në mbledhjet e bordit;

d) dënohet me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale.

6. Mandati i anëtarit, i caktuar si i tillë në cilësinë e kryetarit të shoqatës së kryetarëve të bashkive, përfundon para kohe, vetëm në rast zëvendësimi të kryetarit të shoqatës së bashkive. Në këtë rast anëtar bëhet automatikisht kryetari i ri.

7. Përveç sa parashikohet më sipër, ministri ndërpret mandatin e anëtarëve të bordit, nëse këta të fundit nuk marrin pjesë në asnjë nga mbledhjet e bordit për një periudhë vijuese 6-mujore dhe njofton organin propozues të paraqesë kandidaturat për anëtarin e ri, sipas procedurave të sipërpërmendura, i cili rri në detyrë deri në përfundimin e mandatit të anëtarit që zëvendëson.

8. Bordi mbledhet të paktën një herë në tre muaj dhe në raste të veçanta, me kërkesë të argumentuar të drejtorit të Përgjithshëm të AKU-së, në rastet kur duhen shqyrtuar çështje të karakterit urgjent që lidhen me emergjencat civile, raste pandemie, epidemie dhe ndryshime të rëndësishme buxhetore.

9. Bordi organizohet dhe funksionon në bazë të legjislacionit në fuqi për organizimin dhe



funksionimin e organeve kolegjiale të administratës publike.

10. Kryetari dhe anëtarët e bordit përfitojnë shpërblim, sipas përcaktimeve të vendimit përkatës të Këshillit të Ministrave, për masën e shpërblimit të këshillave, bordeve ose komisioneve të njërive të qeverisjes qendrore.

V. DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

1. Të gjithë nëpunësit/punonjësit në marrëdhënie pune, në momentin e hyrjes në fuqi të këtij vendimi, vazhdojnë marrëdhëniet e punës të rregulluara sipas ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

2. Vendimi nr. 1081, datë 21.10.2009, i Këshillit të Ministrave “Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit”, të ndryshuar, shfuqizohet.

3. Ngarkohen Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

VENDIM Nr. 77, datë 30.6.2020

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KOMISIONIT KOMBËTAR RREGULLATOR NR. 44, DATË 14.10.2016, “PËR LICENCIMIN E SHA UJËSJELLËS- KANALIZIME VORË”

Në mbështetje të nenit 13, 14, 16 dhe 17, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar (ligji nr. 8102), të VKM-së nr. 958, datë 6.5.2009, “Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licencë” (VKM-ja nr. 958), si dhe vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 29, datë 8.12.2009, “Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe

largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar (Rregullore e licencimit),

Komisioni Kombëtar Rregullator,

në mbledhjen e datës 30.6.2020, pasi shqyrtoi çështjen me objekt: “Mbi miratimin e projektvendimit ‘Për një ndryshim në vendimin e Komisionit Kombëtar nr. 44, datë 14.10.2016 ‘Për licencimin e sh.a. Ujësjiellës-Kanalizime Vorë’””,

VËREN SE:

1. Shoqëria Ujësjiellës-Kanalizime Vorë (UK Vorë), me shkresën nr. 289 prot., datë 7.5.2020, me lëndë “Kërkesë për ndryshim të drejtuesit ligjor të sh.a. Ujësjiellës-Kanalizime Vorë”, ka paraqitur pranë Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (ERRU) kërkesën për rinovim të licencës për efekt të ndryshimit të drejtuesit ligjor, të shoqëruar me dokumentacionin sipas përcaktimeve të parashikuara në VKM-në nr. 958 dhe në Rregulloren e Licencimit.

2. Komisioni Kombëtar Rregullator (KKRR) e gjeti paraqitjen e kërkesës së UK Vorë, për rinovim licence për efekt të ndryshimit të drejtuesit ligjor, në konformitet me kriteret dhe procedurën e parashikuar në VKM-në nr. 958 dhe në Rregulloren e Licencimit.

3. KKRR-ja ka licencuar shoqërinë UK Vorë me vendimin nr. 44, datë 14.10.2016, “Për licencimin e sh.a. Ujësjiellës-Kanalizime Vorë”, me një afat 4-vjeçar, ku shoqëria autorizohet të ofrojë shërbimin e grumbullimit dhe shpërndarjes së ujit për konsum publik, si dhe largimit të ujërave të ndotura.

4. Drejtuesi ligjor i shoqërisë UK Vorë sh.a., z. Andi Subashi, ka mbaruar studimet e larta në Juridik.

5. ERRU-ja, në vlerësimin e kërkesës për ndryshimin e licencës për efekt të ndryshimit të drejtuesit ligjor, ka marrë në konsideratë përmbushjen nga ana e UK Vorë sh.a. të kërkesave të ligjit nr. 8102, të VKM-së nr. 958 dhe të Rregullores së Licencimit, në mënyrë të veçantë, sa i takon garantimit që i licencuari të veprojë në përputhje me kushtet e licencës së tij dhe të mbrojë interesat e konsumatorëve në lidhje me cilësinë,



eficiencën, vazhdueshmërinë dhe garancinë e shërbimit.

Për gjithë sa më sipër, Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi arriti në përfundimin se aplikimi i UK Vorë është i bazuar ligjërisht dhe plotëson kërkesat ligjore të parashikuara në kuadrin rregullator në fuqi,

VENDOSI:

1. Në pikën 1, të vendimit të KKRR-së nr. 44, datë 14.10.2016, “Për licencimin e sh.a Ujësjiellës-Kanalizime Vorë” bëhen këto ndryshime:

“Drejtues Ligjor z. Andi Subashi”

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Ndriçim Shani

VENDIM Nr. 78, datë 30.6.2020

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KOMISIONIT KOMBËTAR RREGULLATOR NR. 22, DATË 7.6.2017 “PËR LICENCIMIN E SHA UJËSJIELLËS- KANALIZIME MAT”

Në mbështetje të nenit 13, 14, 16 dhe 17, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar (ligji nr. 8102), të VKM-së nr. 958, datë 6.5.2009, “Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licencë” (VKM-ja nr. 958), si dhe vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 29, datë 8.12.2009, “Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar (Rregullore e licencimit),

Komisioni Kombëtar Rregullator,

në mbledhjen e datës 30.6.2020, pasi shqyrtoi çështjen me objekt: “Mbi miratimin e projektvendimit Për një ndryshim në vendimin e

Komisionit Kombëtar nr. 22, datë 7.6.2017, ‘Për licencimin e sh.a. Ujësjiellës-Kanalizime Mat’”,

VËREN SE:

1. Shoqëria Ujësjiellës-Kanalizime Mat (UK Mat), me shkresën nr. 215 prot., datë 17.6.2020, me lëndë “Dërgojmë dokumentet e administratorit UK Mat, Z. Artan Thomaraj” ka paraqitur pranë Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (ERRU) kërkesën për rinovim të licencës për efekt të ndryshimit të drejtuesit ligjor, të shoqëruar me dokumentacionin sipas përcaktimeve të parashikuara në VKM-në nr. 958 dhe Rregulloren e Licencimit.

2. Komisioni Kombëtar Rregullator (KKRR) e gjeti paraqitjen e kërkesës së UK Mat, për rinovim licence për efekt të ndryshimit të drejtuesit ligjor, në konformitet me kriteret dhe procedurën e parashikuar në VKM-në nr. 958 dhe në Rregulloren e Licencimit.

3. KKRR-ja ka licencuar shoqërinë UK Mat me vendimin nr. 22, datë 7.6.2017, “Për licencimin e sh.a. Ujësjiellës-Kanalizime Mat”, me një afat 4-vjeçar, ku shoqëria autorizohet të ofrojë shërbimin e grumbullimit dhe shpërndarjes së ujit për konsum publik, si dhe largimit të ujërave të ndotura.

4. Drejtuesi ligjor i shoqërisë sh.a. UK Mat, z. Artan Thomaraj, ka mbaruar studimet e larta në Juridik.

5. ERRU-ja, në vlerësimin e kërkesës për ndryshimin e licencës për efekt të ndryshimit të drejtuesit ligjor, ka marrë në konsideratë përmbushjen nga ana e sh.a. UK Mat të kërkesave të ligjit nr. 8102, të VKM-së nr. 958 dhe të Rregullores së Licencimit, në mënyrë të veçantë sa i takon garantimit që i licencuari të veprojë në përputhje me kushtet e licencës së tij dhe të mbrojë interesat e konsumatorëve në lidhje me cilësinë, eficiencën, vazhdueshmërinë dhe garancinë e shërbimit.

Për gjithë sa më sipër, Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi arriti në përfundimin se aplikimi i UK Mat është i bazuar ligjërisht dhe plotëson kërkesat ligjore të parashikuara në kuadrin rregullator në fuqi,



VENDOSI:

1. Në pikën 1, të vendimit të KKRR-së nr. 22, datë 7.6.2017, “Për licencimin e sh.a. Ujësjiellës-Kanalizime Mat” bëhen këto ndryshime:

“Drejtues Ligjor z. Artan Thomaraj”

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Ndriçim Shani

VENDIM
Nr. 91, datë 28.7.2020

PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË
UJËSJELLËS-KANALIZIME BULQIZË
SHA

Në mbështetje të nenit 13, 14, 15, 16 dhe 17, të ligjit nr. 8102, datë 28.03.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar (ligji nr. 8102); të VKM-së nr. 958, datë 6.5.2009, “Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licencë” (VKM-ja nr. 958), si dhe vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 29, datë 8.12.2009, “Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar (Rregullorja e licencimit),

Komisioni Kombëtar Rregullator,

në mbledhjen e datës 28.7.2020, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga Drejtoria Tekniko-Ekonomike dhe Sektori Juridik mbi kërkesën e shoqërisë Ujësjiellës-Kanalizime Bulqizë sh.a. për licencim,

VËREN SE:

1. Shoqëria Ujësjiellës-Kanalizime Bulqizë (UK Bulqizë), me shkresën nr. 339 prot., datë 16.7.2020, ka paraqitur pranë Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (ERRU) kërkesën për rinovim licence për shkak të mbarimit të afatit.

2. Komisioni Kombëtar Rregullator (KKRR) e gjeti paraqitjen e kërkesës për licencim, për shkak të mbarimit të afatit të UK Bulqizë, në konformitet me kriteret dhe procedurën e parashikuar në VKM-në nr. 958 dhe në Rregulloren e licencimit, si dhe në zbatim të parashikimeve të VKM-së nr. 63, datë 27.1.2016, “Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura” (VKM nr. 63).

3. Referuar kërkesës dhe dokumentacionit shoqërues, rezulton se:

a) UK Bulqizë ka përditësuar ekstraktin e regjistrit tregtar, për shkak të riorganizimit të shoqërisë sipas parashikimeve të VKM-së nr. 63;

b) Shoqëria UK Bulqizë ofron shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura për 41,628 banorë në Bashkinë Bulqizë;

c) Drejtuesi teknik i shoqërisë UK Bulqizë sh.a. plotëson kërkesat e VKM-së nr. 958, mbi edukimin dhe eksperiencën në profesion.

4. ERRU-ja, në vlerësimin e kërkesës për licencim për shkak të mbarimit të afatit, ka marrë në konsideratë përmbushjen nga ana e UK Bulqizë, të:

a) kërkesave të ligjit nr. 8102, si dhe të kuadrin rregullator në fuqi, në mënyrë të veçantë plotësimin e kushteve si: aftësi tekniko-profesionale, aftësi financiare të nevojshme për të përmbushur funksionet dhe për të plotësuar kushtet e licencës, përvojën në sektorin e ujësjiellësve dhe kanalizimeve të mjaftueshme për të marrë përsipër detyrimet që ka licenca, si dhe mbrojtjen e interesave të konsumatorëve në lidhje me cilësinë, eficiencën, vazhdueshmërinë dhe garancinë e shërbimit;

b) kërkesave të ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003, “Për mbrojtjen e Konkurrencës”, të ndryshuar, (ligji nr. 9121) për mos lejimin e abuzimit me pozitën dominuese në treg të ndërmarrjes, veçanërisht në lidhje me kufizimin e tregjeve.

5. ERRU-ja, në bazë të vlerësimit dhe verifikimeve të kërkesës së shoqërisë UK Bulqizë, rekomandon:

- Shoqëria UK Bulqizë duhet të aplikojë pranë ERRU-së për miratimin e tarifave të largimit të ujërave të ndotura, shërbim të cilin se kanë pasur më parë.

Për gjithë sa më sipër, Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi arriti në përfundimin se kërkesa e



UK Bulqizë është e bazuar ligjërisht dhe plotëson kërkesat ligjore të parashikuara në kuadrin rregullator në fuqi,

VENDOSI:

1. Licencimin e shoqërisë Ujësjiellës-Kanalizime Bulqizë sh.a. me NUIS: J66702422U, në kategoritë:

a) Kategoria A - Për grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik;

b) Kategoria C - Për largimin e ujërave të ndotura.

2. Shoqëria Ujësjiellës-Kanalizime Bulqizë sh.a. autorizohet të kryejë veprimtaritë e licencuara me:

a) Drejtues Ligjor: Asllan Daxha;

b) Drejtues Teknik: Fisnik Hyseni.

3. Zona e shërbimit të shoqërisë Ujësjiellës-Kanalizime Bulqizë sh.a. është Bashkia Bulqizë.

4. Kjo licencë është e vlefshme për një periudhë 4-vjeçare.

5. Drejtuesi ligjor i shoqërisë Ujësjiellës-Kanalizime Bulqizë sh.a. detyrohet të nënshkruajë kushtet e licencës brenda 10 ditëve nga data e njoftimit.

6. Ngarkohet Drejtoria Tekniko-Ekonomike të njoftojë shoqërinë Ujësjiellës-Kanalizime Bulqizë sh.a. për marrjen e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Ndriçim Shani

VENDIM

Nr. 92, datë 28.7.2020

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KOMISIONIT KOMBËTAR RREGULLATOR NR. 12, DATË 16.2.2018, “PËR LICENCIMIN E SHA UJËSJIJELLËS- KANALIZIME TEPELENË, PËR NDRYSHIM DREJTUESI TEKNIK”

Në mbështetje të nenit 13, 14, 16 dhe 17, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar (ligji nr. 8102), të VKM-së nr. 958, datë 6.5.2009, “Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licencë” (VKM-ja nr.

958), si dhe vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 29, datë 8.12.2009, “Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale, për subjektet juridike e fizike që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar (Rregullorja e licencimit),

Komisioni Kombëtar Rregullator,

në mbledhjen e datës 28.7.2020, pasi shqyrtoi çështjen me objekt: “Mbi kërkesën e shoqërisë Ujësjiellës-Kanalizime Tepelenë sh.a. (UK Tepelenë) për ndryshim të licencës për shkak të ndryshimit të drejtuesit teknik”,

VËREN SE:

1. Shoqëria UK Tepelenë, me shkresën nr. 245 prot., datë 9.7.2020, me lëndë “Kërkesë për ndryshim licence”, ka paraqitur pranë Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (ERRU) kërkesën për rinovim të licencës për efekt të ndryshimit të drejtuesit teknik, të shoqëruar me dokumentacionin sipas përcaktimeve të parashikuara në VKM-në nr. 958 dhe në Rregulloren e Licencimit.

2. Komisioni Kombëtar Rregullator (KKRR) e gjeti paraqitjen e kërkesës së UK Tepelenë për rinovim licence, për efekt të ndryshimit të drejtuesit teknik, në konformitet me kriteret dhe procedurën e parashikuar në VKM-në nr. 958 dhe në Rregulloren e Licencimit.

3. ERRU-ja ka licencuar shoqërinë UK Tepelenë me vendimin nr. 15, datë 28.4.2017, “Për licencimin e sh.a. Ujësjiellës-Kanalizime Tepelenë”, (vendimi i KKRR-së nr. 15, i ndryshuar) me një afat 4-vjeçar, ku shoqëria autorizohet të ofrojë shërbimin e grumbullimit dhe shpërndarjes së ujit për konsum publik, si dhe largimit të ujërave të ndotura.

4. Drejtuesi teknik i shoqërisë UK Tepelenë sh.a. plotëson kërkesat e VKM-së nr. 958 mbi profilin e edukimit.

5. ERRU-ja, në vlerësimin e kërkesës për ndryshimin e licencës për efekt të ndryshimit të drejtuesit teknik, ka marrë në konsideratë përmbushjen nga ana e UK Tepelenë sh.a. të kërkesave të ligjit nr. 8102, të VKM-së nr. 958 dhe



të Rregullores së Licencimit, në mënyrë të veçantë sa i takon garantimit që i licencuari të veprojë në përputhje me kushtet e licencës së tij dhe të mbrojë interesat e konsumatorëve në lidhje me cilësinë, eficiencën, vazhdueshmërinë dhe garancinë e shërbimit.

Për gjithë sa më sipër, Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi arriti në përfundimin se aplikimi i UK Tepelenë është i bazuar ligjërisht dhe plotëson kërkesat ligjore të parashikuara në ligjin nr. 8102 dhe kuadrin rregullator në fuqi,

VENDOSI:

1. Në pikën 1, të vendimit të KKRR-së nr. 12, datë 16.2.2018, “Për licencimin e sh.a. Ujësllës-Kanalizime Tepelenë për ndryshim drejtuesi teknik” bëhet ndryshimi si më poshtë:

“Drejtues Teknik Myftar Beqo”

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Ndrëçim Shani

VENDIM Nr. 99, datë 25.8.2020

PËR MIRATIMIN E TARIFAVE TË SHËRBIMIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE LARGIMIN E UJËRAVE TË NDOTURA PËR SHOQËRINË UJËSJELLËS- KANALIZIME POGRADEC SHA

Në mbështetje të neneve 13, 14, 21 dhe 22, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar (ligji nr. 8102), vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 39, datë 9.12.2015, “Për miratimin e politikës tarifore për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura” (vendimi nr. 39), vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 40, datë 9.12.2015, “Për miratimin e dokumentacionit mbështetës për miratimin e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë, largimin e përpunimit të ujërave të ndotura” (vendimi nr. 40), vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 41, datë 9.12.

2015, “Për miratimin e procesit të miratimit të tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë, largimin e përpunimit të ujërave të ndotura” (vendimi nr. 41), vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 42, datë 9.12.2015, “Për miratimin e metodologjisë për vendosjen e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largim e përpunimit të ujërave të ndotura” (vendimi nr. 42),

Komisioni Kombëtar Rregullator,

në mbledhjen e datës 25.8.2020, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga Drejtoria Tekniko-Ekonomike mbi kërkesën e Ujësllës-Kanalizime Pogradec sh.a., për miratimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe kanalizime,

Vëren se:

Shoqëria “Ujësllës-Kanalizime Pogradec” (UK Pogradec), me shkresë nr. 170 prot., datë 10.4.2020, me lëndë “Kërkesë për nivel të ri tarife për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimin (kanalizime) e ujërave të ndotura” ka paraqitur kërkesën pranë Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (ERRU), për ndryshimin e tarifave në zonën e shërbimit për të tria kategoritë e konsumatorëve të shoqëruar me dokumentacionin, sipas përcaktimeve të parashikuara në ligjin nr. 8102 dhe vendimin nr. 40.

1. Komisioni Kombëtar Rregullator (KKRR), pasi e gjeti paraqitjen e kërkesës për vendosjen e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimin e ujërave të ndotura dhe tarifën fikse të shoqërisë UK Pogradec, në përputhje me përcaktimet dhe procedurën e parashikuar në vendimin nr. 40, me vendimin 61, datë 29.4.2020, vendosi fillimin e procedurës për shqyrtimin e aplikimit për propozimin e bërë nga UK Pogradec për nivelin e ri tarifar për shërbimet UK për të gjithë zonën e riorganizuar të shërbimit në zbatim të VKM-së nr. 63, datë 27.1.2016, “Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura”.

2. Ujësllës-Kanalizime Pogradec, në dokumentacionin e paraqitur pranë ERRU-së, me shkresën nr. 170 prot., datë 10.4.2020, “Kërkesë për nivel të ri tarife për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimin (kanalizime) e ujërave të ndotura”, propozon ndryshim të nivelit tarifar për të tria kategoritë e konsumatorëve, sipas tabelës së mëposhtme:



Tabela me tarifat aktuale dhe të propozuara nga shoqëria sipas kategorisë së konsumatorëve

Kategoritë e klientëve	Tarifat aktuale			Tarifat e propozuara		
	Zona ekzistuese	Zona e shtuar		Zona ekzistuese	Zona e shtuar	
	Pogradec Buçimas	Udenisht Cerravë	Proptisht Velçan Trebinjë Dardhas	Pogradec Buçimas	Udenisht Cerravë	Proptisht Velçan Trebinjë Dardhas
A. Tarifë volumetrike për furnizimin me ujë	lek/m ³	lek/m ³	lek/m ³	lek/m ³	lek/m ³	lek/m ³
1. Klientë familjarë	22/62*	-	-	60	30	20
2. Klientë publikë	37/111*	-	-	111	100	100
3. Klientë privatë	37/111*	-	-	111	100	100
B. Tarifë volumetrike për KUN	lek/m ³	lek/m ³	lek/m ³	lek/m ³	lek/m ³	lek/m ³
1. Klientë familjarë	11/33*	-	-	30	15	15
2. Klientë publikë	12/36*	-	-	40	30	30
3. Klientë privatë	12/36*	-	-	40	30	30
C. Tarifë Fikse për FU	lek/muaj/ lidhje	Faturim aforfe (lek/muaj/lidhje)		Tarifë fikse shërbimi (lekë/muaj/lidhje)		
1. Klientë familjarë	200	100 (Lini 200)	100	200	100	100
2. Klientë publikë	400	500	500	400	100	100
3. Klientë privatë	400	500	500	400	100	100
D. Tarifë Fikse për KUZ	Tarifë fikse shërbimi (lek/muaj/lidhje)			Tarifë fikse shërbimi (lek/muaj/lidhje)		
1. Klientë familjarë	100	-	-	100	100	100
2. Klientë publikë	100	-	-	100	100	100
3. Klientë privatë	150	-	-	150	100	100

*Aktualisht për qytetin Pogradec dhe NJA Buçimas, sipas vendimit nr. 28, datë 19.11.2012, të Komisionit Kombëtar Rregullator, aplikohen dy nivele tarifash volumetrike, si dhe dy tarifa fikse shërbimi për FU dhe për KUZ+ITUN. Niveli (blloku) i parë i tarifës i përket konsumit deri 4,5 m³ ujë/muaj, lidhje, ndërsa niveli i dytë i përket konsumit mbi 4,5 m³/muaj, lidhje. Në zonën e re të shtuar shoqëria për tri kategoritë e klientëve aplikon faturim mujor aforfe.

3. Në aplikimin aktual, duke marrë si referencë vitin e mbyllur 2019, për të cilin shoqëria ka aplikuar tarifat e miratuara nga ERRU-ja për gjithë zonën e shërbimit, referuar tarifave të reja të propozuara shoqëria ka përcaktuar edhe objektivat

që do të realizohen në vitin e ardhshëm. Treguesit kryesorë të performancës për vitin 2019 dhe objektivat për vitin 2020 dhe vitin 2021 jepen në tabelën e mëposhtme.



Treguesit kryesorë të performancës sipas shoqërisë, për vitet 2019–2020–2021

Treguesit e Performancës	Njësia e matjes	Treguesit kryesorë të performancës sipas shoqërisë		
		Viti 2019 (realizuar)	Viti 2020 (objektiva)	Viti 2021 (objektiva)
1. Uji pa të ardhura	%	35.4	40.3	40.3
2. Mbulimi me ujë	%	85.3	85.4	85.4
3. Mbulimi me KUN	%	49.1	49.5	49.5
4. Mbulimi me ITUN	%	49.9	50.2	50.2
5. Niveli i matjes	%	88	73.4	73.4
6. Norma e arkëtimit korrente	%	81	82	82
7. Vazhdimësia e furnizimit me ujë	orë/ditë	21.6	22	22
8. Eficienca e stafit	staf/1000 lidhje UK	4.5	5.4	5.4
9. Mbulimi i kostove O&M	%	119	105	121
10. Mbulimi i kostove totale	%	56	54	57

4. Shoqëria në relacionin e saj e justifikon nevojën e ndryshimit të tarifave, duke dhënë argumentet e mëposhtme:

- Pas riorganizimit në zbatim të VKM-së nr. 63, datë 27.1.2016, “Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura”, shoqëria aplikon për ndryshimin e nivelit tarifor.

- Aplikon për nivel të ri tarifor pas një periudhe të gjatë 8-vjeçare.

- Shoqëria pretendon se aplikimi i tarifave, sipas blloqeve të konsumit, mbron konsumatorin me të ardhura të ulëta por favorizon edhe konsumatorët që kanë shtëpi të dyta apo pushimi në Pogradec dhe penalizon shoqërinë në drejtim të të ardhurave të realizuara për përballimin e kostove.

- Tarifat, sipas konsumit pa blloqe, do të sjellin të ardhura më të larta, me qëllim mbulimin e kostove në nivel më të mirë se ai ekzistues.

- Nevoja për përballimin e kostove të shtuara, si rezultat i zgjerimit të zonës së shërbimit.

- Nevojën për të ardhura shtesë e diktojnë edhe detyrimet që shoqëria ka ndaj institucioneve të kredisë dhe konkretisht:

a) kredia 1.5 milionë euro dhe 540 mijë euro ka nisur të shlyhet dhe vazhdon deri në vitin 2020.

b) kredia në vlerën 4.88 milionë euro ka filluar në vitin 2018 dhe shtrihet për 30 vite.

c) kredia prej 10 milionë eurosh fillon shlyerjen e detyrimeve në vitin 2020.

Treguesit e performancës në përgjithësi kanë pësuar rënie krahasuar me aktivitetin kur UK Pogradec shërbente vetëm Njësinë Pogradec dhe Buçimas. Megjithatë pas zgjerimit të zonës së shërbimit me zonat e reja UK Pogradec përcakton objektiva me tendencë në rritje.

Ujësjiellës-Kanalizime Pogradec, me tarifën e reja të propozuara synon një situatë financiare më të favorshme për të mbuluar kostot e operimit dhe mirëmbajtjes mbi 100%, si edhe të arrijë të mbulojë kostot e interesave duke mbajtur të njëjtat nivele të normës së arkëtimit.

5. Gjatë procesit të analizës teknike ekonomike, sipas metodologjisë së llogaritjes së tarifave të përcaktuar në vendimin nr. 42, ERRU-ja ka kërkuar informacion shtesë nga UK Pogradec, si dhe verifikim të saktësisë së të dhënave të vëna në dispozicion nga shoqëria.

6. ERRU-ja, në vlerësimin e tarifave të propozuara dhe treguesve të performancës, si dhe në analizën ekonomike financiare, ka marrë në konsideratë përmbushjen nga ana e UK Pogradec, të:

a) kërkesave të ligjit nr. 8102, si dhe të akteve nënligjore dhe kuadrit rregullator në fuqi, në mënyrë të veçantë mbrojtjen e konsumatorëve nga çmimet monopol;



b) kërkesave të ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, të ndryshuar (ligji nr. 9121), për moslejimin e abuzimit me pozitën dominuese në treg të ndërmarrjes nëpërmjet vendosjes, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, të çmimeve të padrejta të shitjes apo të kushteve të tjera të tregtimit;

c) kërkesave të ligjit nr. 9902, datë 17.4.2008, “Për mbrojtjen e konsumatorëve”, të ndryshuar (ligji nr. 9902);

d) orientimin drejt mbulimit të kostove totale, pasi aktualisht shoqëria bën pjesë në grupin e shoqërive që tentojnë mbulimin e këtyre kostove;

e) tarifat e propozuara nga operatori të jenë në përputhje të plotë me parimin ligjor rregullator mbi përballueshmërinë, sipas të cilit tarifat duhet të jenë të përballueshme;

f) tarifat e propozuara nuk sjellin për pasojë efekte negative në mjedis nga veprimtaria e operatorit në zonën e shërbimit që ato do të aplikohen;

g) propozimin për ndryshimin e tarifave nga shoqëria, ERRU-ja e gjen të justifikuar, por jo në nivelin e propozuar nga shoqëria, referuar kjo analizës tekniko-ekonomike, si dhe realizimit të objektivave të performancës të përcaktuar në aplikimin paraardhës.

Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi vlerësoi tarifat e propozuara nga operatori mbi bazën e metodologjisë të miratuar me vendim nr. 42, datë 9.12.2015, “Për miratimin e metodologjisë për vendosjen e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largim e përpunimin e ujërave të ndotura”, si dhe akteve të tjera rregullatore që lidhen me të, arrin në konkluzionin se tarifat e propozuara, sipas analizës së kryer, janë të bazuara dhe në zbatim të kriterëve ligjore referuese lidhur me kostot e pranueshme dhe të justifikuara, si dhe përballueshmërinë, nuk janë të padrejta dhe të vendosura në kushtet e abuzimit me pozitën dominuese në treg të operatorit ekonomik, në kuptim të ligjit nr. 9121, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, të ndryshuar, dhe ligjin nr. 9902, “Për mbrojtjen e konsumatorëve”, për gjithë sa më sipër, në zbatim të neneve 13, 14 dhe 22 të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar,

VENDOSI:

1. Miratimin e tarifave për shoqërinë Ujësjellës-Kanalizime Pogradec, si më poshtë:

Kategoria	Tarifat sipas aktit në zonën e shërbimit	
	Pogradec Buçimas	Udenisht, Cerravë, Proptisht, Velçan, Trebinjë, Dardhas
Tarifë volumetrike për furnizimin me ujë	lek/m³	lek/m³
Konsumatorë familjarë	60	30
Konsumatorë publik	111	100
Konsumatorë privat	111	100
Tarifë volumetrike për KUN	lek/m³	lek/m³
Konsumatorë familjarë	30	15*
Konsumatorë publik	40	30*
Konsumatorë privat	40	30*
Tarifë fikse	lek/muaj/lidhje	lek/muaj/lidhje
Konsumatorë familjarë	200	100
Konsumatorë publik	300	100
Konsumatorë privat	300	100

* Këto tarifa do të zbatohen vetëm në rast se do të ofrohet ky shërbim në të ardhmen si rezultat i investimeve fizike për ndërtimin e rrjeteve të KUN.

2. Objektivat e treguesve kryesorë të performancës të vitit 2021 për shoqërinë UK Pogradec do të jenë:



Treguesit e performancës	Njësia e matjes	Niveli i objektivit për vitin 2021 të përcaktuar nga ERRU
Mbulimi i kostove O&M	%	119
Mbulimi i kostove totale	%	79
Uji pa të ardhura	%	33.3
Niveli i matjes	%	73.4
Vazhdimësia e furnizimit me ujë	orë/ditë	23
Eficienca e stafit	staf/1000 lidhje	5.4
Mbulimi me ujë	%	85.4
Mbulimi me KUN	%	49.5
Norma e arkëtimit korrente	%	84

3. ERRU-ja, në bazë të analizës, verifikimeve dhe komunikimit me stafin drejtues të shoqërisë i konsideron të arritshëm objektivat mbi treguesit kryesore të performancës dhe

REKOMANDON:

a) Shoqëria duhet të hartojë plan-biznesi afatgjatë (pesëvjeçar), duke marrë në konsideratë situatën aktuale të zonës së shërbimit pas riorganizimit, me objektiva dhe plane veprimi për realizimin e tyre.

b) Të hartojë planet e veprimit dhe të ndërmarrë aksionin për gjetjen dhe eliminimin e të gjitha lidhjeve të paligjshme në rrjetin e transmetimit dhe të shpërndarjes, sidomos në zonën e shtuar rurale. Aksioni për evidentimin e tyre duhet mbajtur parasysh sidomos gjatë zbatimit të investimeve të pritshme në njësitë administrative Udenisht dhe Propisht.

c) Të evidentojë të gjithë klientët në zonën e shërbimit sidomos në zonat rurale të shtuara.

d) Shoqëria duhet të hartojë një bilanc uji sa me real që do të jetë rezultat i një analize të thelluar në terren për të gjetur shkaqet e vërteta të rrjedhjeve, si faktor i rëndësishëm për uljen e humbjeve reale (teknike) dhe atyre administrative që shkaktohen nga linjat e tubacioneve të transmetimit dhe ato të shpërndarjes të sistemeve, sidomos për zonat rurale të shtuara.

e) Të bëjë përpjekje për të realizuar instalimin e matësve të mëdhenj në pikat e prodhimit të ujit dhe në pikat kyçe të rrjeteve shpërndarëse, si dhe ato individuale për të gjithë klientët.

f) Referuar analizës, shoqëria, detyrimisht duhet të aplikojë për nivel të ri tarifor në vitin 2022 me efekt ekonomik në vitin pasues.

g) Të hartojë inventarin e detajuar të aseteve sipas vitit të instalimit të tyre, së bashku planin e menaxhimit të aseteve, i cili mund më tej të përfshihet në planin 5-vjeçar të biznesit.

h) Të argumentojë në të ardhmen në mënyrë të plotë organigramën e stafit për secilin pozicion për detyrat dhe përshkrimin e punës.

4. Pagesa rregullatore vjetore për shoqërinë Ujësjellës-Kanalizime Pogradec sh.a. do të jetë 0.6% e të ardhurave vjetore të parashikuara nga aktiviteti, përkatësisht 1,044,000 lekë/vit.

5. Lidhjen e kontratës me UK Pogradec, brenda 30 ditëve nga data e njoftimit, sipas pikës 4 të nenit 22, të ligjit nr. 8102.

6. Vendimi nr. 28, datë 19.11.2012, “Për miratimin e tarifave të ujit për konsum publik për shoqërinë UK Pogradec sh.a”, shfuqizohet.

7. Ky vendim hyn në fuqi më datë 1.10.2020 dhe është i vlefshëm deri në miratimin e tarifave të reja.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Ndriçim Shani



VENDIM

Nr. 100, datë 25.8.2020

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN
NR. 39, DATË 1.6.2018, “PËR
LICENCIMIN E SHA UJËSJELLËS-
KANALIZIME KONISPOL”**

Në mbështetje të nenit 13, 14, 16 dhe 17, të ligjit nr. 8102 datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar (ligji nr. 8102); të VKM-së nr. 958, datë 6.5.2009, “Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licencë” (VKM nr. 958); si dhe vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 29, datë 8.12.2009, “Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar (Rregullorja e licencimit),

Komisioni Kombëtar Rregullator,

në mbledhjen e datës 25.8.2020, pasi shqyrtoi çështjen me objekt: “Mbi miratimin e projektvendimit Për një ndryshim në vendimin e Komisionit Kombëtar nr. 39, datë 1.6.2018, Për licencimin e sh.a. Ujësjiellës-Kanalizime Konispol””,

VËREN SE:

1. Shoqëria Ujësjiellës-Kanalizime Konispol (UK Konispol), me shkresën nr. 75 prot., datë 21.7.2020, me lëndë “Dërgim dokumentacioni për ndryshimin e drejtuesit ligjor dhe drejtuesit teknik të sh.a. Ujësjiellës-Kanalizime Konispol” ka paraqitur pranë Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (ERRU) kërkesën për rinovim të licencës, për efekt të ndryshimit të drejtuesit ligjor dhe drejtuesit teknik, të shoqëruar me dokumentacionin, sipas përcaktimeve të parashikuara në VKM-në nr. 958 dhe në Rregulloren e Licencimit.

2. Komisioni Kombëtar Rregullator (KKRR) e gjeti paraqitjen e kërkesës së UK Konispol, për

rinovim licence për efekt të ndryshimit të drejtuesit ligjor dhe drejtuesit teknik, në konformitet me kriteret dhe procedurën e parashikuar në VKM-në nr. 958 dhe në Rregulloren e Licencimit.

3. KKRR-ja ka licencuar shoqërinë UK Konispol për herë të parë me vendimin nr. 39, datë 1.6.2018, “Për licencimin e sh.a. Ujësjiellës-Kanalizime Konispol”, me një afat 4-vjeçar, ku shoqëria autorizohet të ofrojë shërbimin e grumbullimit dhe të shpërndarjes së ujit për konsum publik, si dhe largimit të ujërave të ndotura.

4. Drejtuesi ligjor i shoqërisë UK Konispol sh.a., z. Altier Xhaferi, ka mbaruar studimet e larta në Ekonomi në vitin 2009.

5. Drejtuesi teknik i shoqërisë UK Konispol sh.a., z. Aurenc Shehu, ka mbaruar studimet e larta Master Profesional në Inxhinieri e Burimeve Natyrore, në profilin Gjeomatik, në vitin 2013.

6. ERRU-ja, në vlerësimin e kërkesës për ndryshimin e licencës për efekt të ndryshimit të drejtuesit ligjor dhe drejtuesit teknik, ka marrë në konsideratë përmbushjen nga ana e UK Konispol sh.a. të kërkesave të ligjit nr. 8102; të VKM-së nr. 958 dhe të Rregullores së Licencimit, në mënyrë të veçantë sa i takon garantimit që i licencuari të veprojë në përputhje me kushtet e licencës së tij dhe të mbrojë interesat e konsumatorëve në lidhje me cilësinë, eficiencën, vazhdueshmërinë dhe garancinë e shërbimit.

Për gjithë sa më sipër, Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi arriti në përfundimin se aplikimi i UK Konispol është i bazuar ligjërisht dhe plotëson kërkesat ligjore të parashikuara në kuadrin rregullator në fuqi,

VENDOSI:

1. Në pikën 1, të vendimit të KKRR-së nr. 39, datë 1.6.2018, “Për licencimin e sh.a. Ujësjiellës-Kanalizime Konispol” bëhen këto ndryshime:

“Drejtues Ligjor Altier Xhaferi”

“Drejtues Teknik Aurenc Shehu”

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Ndriçim Shani

*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik
(Qendra e Botimeve Zyrtare)*

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2020

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 196 lekë